



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:165749

Datë: 03.12.2024

Numri i dokumentit: 06581882

2023:165750

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm,- Divizioni Civil, gjyqtari Burhan Berisha, si gjyqtar individual, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. L. nga Kaçaniku, të cilët me autorizim e përfaqëson avokat Q. B. nga Kaçaniku, kundër të paditurës Komuna H. E. - D. A. , në çështjen kontestuese kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik, të drejtpërdrejt dhe në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën datë 20.11.202, merr dhe shpall, ndërsa më datën 03.12.2024 përpilon me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.MIRATOHET, pjesërisht si e bazuar, kërkesa padia e paditëses S. L. nga Kaçaniku dhe **DETYROHET** e paditura K. H. E.-D. e A., që paditëses në emër të kompensimit për shpenzimeve të ushqimit-shujtave për periudhën 22.01.2021 deri 21.11.2022, respektivisht për 340 dite të pranisë në punë, t'ia paguaj shumën prej 680.00€, me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 26.07.2023 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën përfundimtare.

II.REFUZOHET, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses S. L. , në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit edhe atë për shumën prej 476.00€ respektivisht për 340 dite, SI E PA BAZUAR.

IV.DETYROHET, paditësja që kësaj gjykate të ia paguaj shumën prej 20.00€, , në emër të taksës për padi, e cila pagesë do të bëhet, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit.

V. DETYROHET e paditura K. H. E.-D. e A., që paditëses t'ia paguaj shumën si ne pikën I te dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 259.20€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

A r s y e t i m i

Paditësja përmes të autorizuarit të saj Av. Q. B. nga Kaçaniku, me datë 26.07.2023, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, K. H. E.-D. e A., për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit-shujtave dhe udhëtimit, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në shkollën Filllore të Mesme të Ulët "...", në Han të Elezit, si mësimdhënëse e lëndës së gjuhës shqipe, e njëjta vendin e punës e ka vijuar me rregull nga data 22.01.2021 deri me datën 30.12.2022, dhe për të njëjtën e paditura nuk e ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit gjatë ditëve të punës ashtu siç përcaktohet në Kontratën Kolektive të Arsimit.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj në padi ashtu edhe gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se baza ligjore e kërkesëpadsisë ekziston në Kontrata Kolektive e Arsimit të datës 22.04.2021, me nenin 35 par. 5 dhe 7. Me këto dispozita është paraparë kompensimi shpenzimet e ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 euro për të punësuarin që ka marrëdhënien e punës primare në institucionin arsimor si dhe punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimin e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës prej 70% të biletave të trafikut urban, prandaj nga këto baza, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadsinë e paditësit ta miratojë në tersi si të bazuar.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 21.11.2023, e ka precizuar kërkesëpadsinë, ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesëpadsisë, dhe e ka caktuar periudhën kohore nga 22.01.2021 deri 21.11.2022 për kompensimin për ushqim dhe shpenzimeve të udhëtimit.

Shpenzimet i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se sa i përket shujtave kanë arritur marrëveshje për pagesën e tyre sipas orëve të përcaktuara me vërtetimin të shkollës ndërsa përpjesën tjetër të udhëtimit, me nenin 35.7 të KKA, është përcaktuar se punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës prej 70% të biletave të trafikut urban, që nënkupton se

këtu e paditura nuk ka kompetencë as për padi e as për shpërblimet e udhëtimit. Gjithashtu ka deklaruar se paditësja nuk ka as dëshmi të qarte lidhur me udhëtimin, andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesën për shpenzimet e udhëtimit, ta refuzojë si të pa bazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimet e tyre për ti parashtruar ato si dhe duke u bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka administruar këto prova edhe atë: Kontrata e punës me nr. Protokolli 05/11149, certifikata e vendbanimit me nr. serik B 10545621, si dhe vërtetimi i lëshuar nga Stacioni i Autobusëve Kaçanik, i datës 17.05.2024..

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura me detyrat e mësimdhënësës. Kjo marrëdhënie është e rregulluar përveç tjerash me Kontratën Kolektive të Arsimit të datë 22.01.2021, mbi bazën e së cilës paditësës i takon e drejta në kompensimin e shpenzimeve të shujtave ditore, për të cilën të drejtë nuk është kompensuar nga ana e punëdhënësit për periudhën 22.01.2021 deri 21.11.2022. Ndërsa kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit është e pa bazuar.

a) Se paditësja është në marrëdhënie pune, tek e paditura, në pozitën mësimdhënësës, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga thëniet në padi, si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë kontratat e punës me nr. 06/143/2020. Ky fakt nuk ishin kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse.

b) Se e drejta për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, i takon paditësës, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, të datës 22.01.2021, edhe atë kjo e drejtë ju takon konfrom nenit 35 të kësaj kontrate.

c) se pala e paditur nuk e ka përmbushur, detyrimin, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar me vet faktin se paditësja kanë paraqitur padi në gjykate. Po ashtu ky fakt vërtetohet edhe nga

përgjigja në padi, e paraqitur nga e paditura, e cila ka theksuar se këtë pagesa nuk janë bërë për arsyeje se nuk janë nënshkruar të kësaj kontrate.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, përgjigjes në padi dhe precizimit të kërkesave nga pala paditëse, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Gjykata kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, e ka miratuar si të bazuar, duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, të datës 22.01.2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive, ku është përcaktuar se: “Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për t’u bërë kompensimin”.

Gjykata sa i përket kohëzgjatjes së ditëve të udhëtimit këtë fakt e vërtetoi nga thëniet në precizimin e kërkesë padisë, dhe për 339 dite pune, ia njohu shumën prej 678.00€, e që ky fakt nuk ishte kontestues as nga e paditura, ngase përfaqësuesi i të paditurës në fjalën përfundimtare ka deklaruar sa i përket kërkesës për shpenzimet e shujtave janë të gatshme që të hynë në marrëveshje me paditësen.

Duke qenë se në rastin konkret ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në emër të shpenzimeve të ushqimit, e njëjta është e legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata refuzoi kërkesëpadijë e paditëses, sa i përket shpenzimeve të udhëtimit sepse nga certifikata e vendbanimit me nr. serik B ..., të lëshuar nga ZGJC Kaçanik, e datës 17.05.2024, vërtetohet se paditësja S. L. ka vendbanimin në rrugën "...", komuna Kaçanik, ndërsa nga Kontrata e punës me nr. Protokolli 05/11149, vërtetohet se paditësja punon si mësimdhënëse e mësimi klasor, në SHFMU "...", në Komunën e H. E.. Sipas nenit 35.5 të Kontratës kolektive thuhet se: "Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban". Duke u mbështetur në faktet e cekura më sipër, vërtetohet fakti se paditësja nuk udhëton brenda vendbanimit të komunës përkatëse ku edhe punon, Prandaj gjykata vlerëson se kërkesëpadija e paditëses lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit duhet të refuzohet.

Ne rastin konkret gjykata edhe pse ka pasur prove, siç është vërtetimi I Stacionit të Autobusëve Kaçanik, megjithatë kjo nuk vërteton që ky udhëtim është realizuar brenda komunës së H. të E., ku edhe është vendi i punës së paditëses, e që rrjedhimisht është në shperputhje me depozitën e lartcekur të Kontratës Kolektive të arsimit, të interpretuar si me lartë, pasi që e njëjta kontratë nuk e njeh kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë territorit të komunës përkatëse të vendit të punës.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës së palës paditëse e ka caktuar edhe kamatën duke u bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e paraqitjes së padisë pra nga data 26.07.2023, e deri në pagesën definitive. Këtë kamatë e ka caktuar duke u bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020.

Gjykata i analizoi theksimet e paditëses të paraqitura me padi dhe parashtresë mbi precizimin e kërkesëpadijë, si dhe gjatë seancave gjyqësore, me të cilën kanë kërkuar që këto kërkesa të aprovohen në tërësi si të bazuara dhe të detyrohet e paditura që të ia paguaj shumat si në precizimin e kërkesëpadijë, këtyre theksimeve gjykata pjesërisht ua fali besimin dhe vendosi si në dispozitivit të aktgjykimit duke u mbështetur edhe në provat konkrete të bashkangjitura në shkresat e lendes.

Gjykata i ka analizuar edhe theksimet e palës së paditur të paraqitura gjatë seancave gjyqësore e cila ka kërkuar që kërkesëpadija të refuzohet në tërësi si e pa bazuar nga fakti se i mungon baza ligjore relevante, ngase Kontrata Kolektive e Arsimit e nënshkruar me datë 22.01.2021 është shfuqizuar nga ana e Ministrisë së Arsimit me datë 21.11.2022, gjithashtu ka

theksuar se kjo kontrate nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës, është nënshkruar nga SBASHK dhe Ministri i Arsimit, e që nuk mund ti vihet në barre të komunave, e që këto pretendime nuk i mori për bazë për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e datës 22.01.2021, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”

Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës, ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës.

Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate dhe nuk mund ti vihet në barre të komunave, një pretendim të tillë gjykata nuk e mori për baze, për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Gjykata i obligoi palën paditëse ta paguaj shumën prej 20.00.€, në emër të taksës për padi, sepse pala paditëse nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 253 par. 4 te LPK-se, ku pala paditëse ka pasur detyrim që padisë, të ia bashkëngjis dëshminë mbi pagesën e taksës gjyqësore, konform Udhëzimit Administrative për Unifikimin e Taksave Gjyqësore 01/2017.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shume prej 259.20 €, edhe atë shume prej 104.00€, për përpilim e padisë, shumen prej 135.20€ për përfaqësim në seance gjyqësore dhe shumën prej 20.00€, në emër të taksës për padi. Gjykata vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 452.1 te LPK-se, ndërsa taksën gjyqësore e ka caktuar konform udhëzimit administrativ 01/2017 te KGJK-se.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega Kaçanik

2023:165750, prej datës 20.11.2024

Gjyqtari,

Burhan Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.